



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 70, datë 28.06.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË DYTË PARAPRAKE TË 5 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Komsioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së dytë paraprake të 5 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, hartuar nga Komsioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.06.2022



ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TE ZONA VE TE REJA

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	ZONA E RE
1	MANEZ	NEXHMIJE	SELMAN	LLESHI	7	3+1	MANEZ
2	MANEZ	RIFAT	SHABAN	BEQJA	2	1+1	MANEZ
3	ISHËM	KAJE	XHELAL	JANGOZI	2	1+1	MANEZ
4	MANEZ	FATIME	HYSEN	DISHA	9	3+1	MANEZ
5	MANEZ	SHERIF	IMER	BEHLULI	5	3+1	MANEZ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 529/prot.
2

Durrës, më 04.07.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.70 datë 28.06.2022 Për miratimin e listës së dytë paraprake të 5 familjeve që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26.11.2019 të cilët do të përfitojnë nga programi zhvillimit të zonave të reja”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

